



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE

Legjislatura III
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 24. 6. 2008, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Sabri Hamiti, Naser Rugova, Njomza Emini, Dezair Murati, Nait Hasani, Hydajet Hyseni dhe Edita Tahiri.

Munguan: Fatmir Rexhepi, Branislav Grbić dhe Bujar Bukoshi

I ftuar: Michele Dinelli.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi

Pjesëmarrës të tjerë: Shaqir Mala, Avni Zuka - NDI, Ermal Krasniqi - NDI, Blerim Vela – OSBE dhe Agron Demi - Instituti GAP.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit me këtë

Rend Dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10. 06. 2008,**
- 3. Prezantim i z. Michele Dinelli – ekspert për çështje ligjore - lidhur me shqyrtimin e ligjeve nga ana e Komisionit të Integritimeve Evropiane,**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10. 06. 2008

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

Zylfije Hundozi - Kaloi në pikën e radhës.

3. Prezantim i z. Michele Dinelli – ekspert për çështje ligjore - lidhur me shqyrtimin e ligjeve nga ana e Komisionit të Integritimeve

Zylfije Hundozi – E ftoi z. Dinelli të sqarojë se si Komisioni i Integritimeve Evropiane duhet të punojë në përafrimin e legjislacionit me Acquis communautaire.

Michele Dinelli - Falënderoi për ftesën për pjesëmarrje në Komision. Theksoi se Komisioni i Integritimeve Evropiane është një komision i rëndësishëm, sepse integrimi evropian është një ndër çështjet kyçe për Kosovën, andaj do të flasim për çështje ligjore të rëndësishme për integritime evropiane. Tha se në Kosovë kishte punuar 3 vjet në Zyrën Ligjore të Kryeministrit dhe në Agjencinë e Integritimeve Evropiane që ka për detyrë ta verifikojë përafrimin e legjislacionit me BE. Theksoi se traktatet ndërkombëtare janë bazë ligjore fundamentale, sepse Bashkimi Evropian i ofron disa dokumente specifike për obligimet e shteteve anëtare dhe të shteteve që dëshirojnë të jenë anëtare, në mënyrë që të arrihen qëllime specifike, siç është përafrimi i ligjeve.

Ky është një proces ligjor, në të cilin institucionet duhet ta harmonizojnë kornizën ligjore me parimet kryesore të Acquis communautaire. Në materialin e përgatitur për anëtarët e Komisionit, tha se e kishte paraqitur bazën ligjore, që konsiderohet e rëndësishme, në të cilën janë paraqitur të gjitha traktatet, rregulloret, direktivat dhe konventat, që duhen të zbatohen nga shtetet anëtare dhe shtetet që duhen të jenë anëtare, siç është edhe Kosova. Prandaj, kur flasim për harmonizimin e legjislacionit, duhet të kemi kujdes të respektohen principet evropiane. Në material është paraqitur një listë e traktateve që ofron bazën ligjore evropiane dhe të Acquis communautaire që është i ndarë në 20 kapituj dhe konsiderohet si një libër voluminoz që përmban tërë ligjin evropian. Ai tha se mjafton ta keni një harmonizim me bazat kyçe dhe hapi fundamental për integrim sa i përket ligjeve është të verifikohet se ligjet nacionale që i nxjerr Qeveria a i respektojnë këta kapituj dhe principet bazike të legjislacionit evropian. Duhet të ekzistojë edhe kontrolli nga ministria dhe për këtë ekziston Agjencia e Integritimeve Evropiane që i verifikon ligjet nacionale se a janë në përputhje me Acquis communautaire. Komisionit i Kuvendit duhet të vërtetojë se a janë në harmoni ligjet nacionale me legjislacionin e BE-së, sepse në fund kur presidenti e nënshkruan ligjin, ky ligj duhet të jetë në përputhje të plotë me Acquis communautaire dhe me kapitujt e tij. Nëse vërtetojmë se ligjet nacionale janë në

përputhje me legjislacionin evropian, atëherë edhe hapat do të jenë më të shpejtë drejtë integritimit evropian.

Zylfije Hundozi - Në vazhdim e hapi diskutimin për parashtrimin e pyetjeve.

Hydajet Hyseni – E falënderoj z. Dinel për paraqitjen e tij të qartë dhe për dokumentin e ofruar, sepse konsideroj se kishte nevojë komisioni për një formë të tillë të komunikimit. Pyeti se cilat janë mundësitë e vazhimit të bashkëpunimit të tillë dhe për një çështje aktuale tha në praktikën tonë. Në emër të standardeve evropiane pretendohej të na imponohej diçka që nuk gjendej në legjislacionin evropian, as në parimet e Acquis communautaire. P.sh.: Në fushën e decentralizimit janë imponuar praktika që nuk janë evropiane dhe janë në kundërshtim me parimet e Konventës Evropiane, ose në fushën e kulturës, janë imponuar zgjidhje të pjesshme, që janë në kundërshtim me parimet e UNESCO-së. Pra, a është e nevojshme të kihet kujdes në të dy skajet: njëri t'i përmbushë nivelet evropiane, kurse tjetri të mos i kalojë ato, andaj në emër të standardeve evropiane të mos bëhen zgjidhje absurde, pa precedent dhe zgjidhje që janë kontraproduktive.

Michele Dinelli - Tha se - së pari - Acquis communautaire nuk i mbulon të gjitha sferat e jetës institucionale dhe të përditshme, por Acquis communautaire i saktëson rregullat që shtetet anëtare dhe shtetet që kandidojnë të jenë anëtare, duhet t'i respektojnë këto rregulla dhe parime. Përderisa nuk respektohen ose ka vonesa në zbatimin e tyre, atëherë flitet për dhunë ndaj ligjeve. Acquis communautaire nuk i imponon gjërat negative, imponon gjëra të drejta për të gjithë, por rasti i Kosovës është më ndryshe, sepse së pari duhet të respektohen gjërat e zbatueshme bazike. Është me rëndësi t'i dini cilat janë parimet e përgjithshme të ligjeve evropiane.

Sabri Hamiti - në frymën e dialogut të nisur nga z. Hyseni dhe z. Dinelli dha një koment, në të cilin tha se sa e kam kuptuar z. Hyseni i cili tha se në emër të një univerzaliteti të vlerave që i ofron Acquis communautaire, po shkohet në teprime në Kosovë dhe po lidhem me atë që e tha z. Dinelli, se Kosova nuk është e zonja ti merë këto standarde, është e kundërta, ka shkua në ekstremin tjetër, po ju them se ekziston Ligji evropian për gjuhët regjionale dhe kulturore, por Franca po e refuzon nuk po e pranon, ndërsa te ne ka pretendime të bëhen gjuhë shtetërore, andaj këtu kemi të bëjmë me 2 kultura politike që janë të ndryshme.

Nait Hasani - Tha se Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Paketën e Ahtisarit dhe kjo paketë i tejkalon parimet e Acquis communautaire, pyes z. Dinelli se BE-ja a do ta miratojë Pakon e Ahtisarit?

Michele Dinelli - Tha se kemi të bëjmë me dy gjëra: njëra është Pakoja e Ahtisarit, kurse tjetra Acquis communautaire. Pakoja e Ahtisarit ka të bëjë me UNMIK-un, ndërsa tjetra me integritet në Bashkësinë Evropiane, por Pakoja e Ahtisarit ka të bëjë me çështje specifike, siç janë të drejtat e minoriteteve. Sa më shumë arritje që bëhen sot, sa u përket standardeve, aq më i lehtë do të bëhet integrimi.

Edita Tahiri – Ia parashtrori dy pyetje z. Dinelli:

1. Ju, si ekspert ligjor, a keni ndonjë listë çështjesh nga përvoja e vendeve që e kanë kaluar procesin e integrimit ligjor dhe ato përvoja pastaj kanë qenë negative për ato vende?
2. Është një numër vendesh, përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor, që janë në procesin e integrimi, mirëpo Traktati i Lisbonës, që i hap dyert për zgjerim të më tej të BE-së, u refuzua nga Irlanda dhe vendimmarrja në BE është në bazë të konsensusit, nëse një shtet refuzon, atëherë nuk ka mundësi të ratifikohet Traktati i Lisbonës. Kur e rikujtojmë faktin se Franca dhe Holanda e kanë refuzuar Kushtetutën Evropiane, a mendoni se do të tejkalohen këto pengesa dhe të tjerat? Në raport me Ballkanin, a jeni optimist, deri sa ne i plotësojmë kriteret, a do të hapet rruga për atje?

Michelle Dinelli - Tha se është e vërtetë se procesi vonohet, nëse flasim për Unionin Evropian, që është formuar nga 6 shtete dhe tani janë më shumë shtete anëtare dhe i kemi edhe disa shtete potenciale për t'u integruar. Shtetet anëtare kanë kaluar nëpër procesin e integrimi, por çka ndodh nëse shteti që kërkon të integrohet nuk i plotëson obligimet, ose vonohet. Shteti nuk mund të refuzohet, por mund vetëm t'i shtyhet procesi. Nga momenti kur vendi kërkon anëtarësim, mund të kalojnë dy, por mund të kalojnë edhe 15 vjet deri sa të integrohet, por, derisa ka vullnet për t'u integruar, është shumë e rëndësishme. E njëjta gjë është edhe me Ballkanin. Mund të ndodhë që merr më shumë kohë për t'u integruar, por mund të integrohet edhe më shpejt. Sa i përket Traktatit për Francën dhe Holandën, janë çështje institucionale dhe tani numri ulëseve në Parlament ka ndërruar dhe sa më pak që veprohet më vështirë është të arrihen suksese. Është e rëndësishme që të kenë vullnet politik që të arrihet ky cak, që Kosova të jetë e integruar. Kjo është në duar të institucioneve dhe është e arritshme. Nëse e krahasojmë Kosovën me disa shtete të tjera ballkanike, ende disa ligje jugosllave po i rregullojnë disa fusha, por është më lehtë që Kosova të krijojë një legjislacion të ri në përputhje me Acquis communautaire dhe t'i ndryshojë ato. Kosova po krijon legjislacion të ri që shumë lehtë mund të zbatohen nëse ligjet do të harmonizoheshin me Acquis communautaire.

Sabri Hamiti - Tha se ne kemi vullnet të shkojmë në Evropë dhe ky është deklaram i përgjithshëm. Ne me Kushtetutë kemi kodifikuar një prani evropiane që e konsiderojmë si lidhje me Evropën. Problemi është se sa ndikon kriza kushtetuese evropiane në ritmin e shkuarjes së Ballkanit Perëndimor në BE, në këtë rast Kosova, kur i kemi dy kriza të njëpasnjëshme, e para ka rënë Kushtetuta Evropiane dhe e dyta ka rënë Traktati i Lisbonës. Faktikisht mënyra e vendosjes është Traktati i Nicës, sepse një nga themeluesit e BE-së, Franca, përmes zërit të Sarkozisë, ka thënë këto ditë se nuk ka zgjerim të BE-së përderisa të kalojë kriza institucionale. Pyetja që na intereson është: Çka nëse kjo krizë institucionale vazhdon?

Michelle Dinelli - Pyetjen e z. Hamiti nuk e konsideron të lehtë për përgjigje, sepse nuk e di saktësisht të ardhmen e BE-së. Ekziston një konfidencë e madhe për të saktësuar. Është vështirë të merret vendimi, kurse sa u përket integrimi, shpresoj se është pjesë e hapur.

Hydajet Hyseni - Ne do të përpiqemi ta ndryshojmë atë çka mundemi ta ndryshojmë. Gjendemi në kushte specifike dhe e kemi të vështirë ta kuptojmë dokumentin e Ahtisarit, sepse është një dokument politik, atëherë në çfarë raporti do ta trajtojmë dokumentin e

Ahtisarit me dokumentet universale të të drejtave të njeriut? Në këtë dokument kemi zgjidhje që janë të pazbatueshme dhe janë në kundërshtim me parimet elementare të të drejtave të njeriut. P.sh. po e ilustrim një fakt: është një dispozitë me të cilën komuniteteve minoritare u garantohet e drejta që vetë të vendosin për emërtimet e vendbanimeve të tyre, që nuk e ka kundërshtuar askush, por kur vjen puna te vendbanimet e komunitetit shumicë, atëherë këtë të drejtë ai nuk e ka. A do të bëhet Kuvendi i Kosovës rob edhe i këtyre formulimeve që nuk i duhen askujt, sepse nuk janë në funksion të realizimit të të drejtave të komuniteteve minoritare, por janë kufizime për të drejtat e komunitetit shumicë. Në këtë rast, çka duhet të bëjmë ne? A do t'i shkelim të drejtat universale të njeriut dhe parimet e Acquis communautaire për shkak të një absurdi që i është përvjedhur dokumentit të Ahtisarit, apo dokumenti i Ahtisarit duhet t'u përshtatet standardeve ndërkombëtare?

Michelle Dinelli - Tha se sigurisht mund të ketë probleme në zbatimin e Pakos së Ahtisarit dhe të strategjisë evropiane, sepse nuk i di metodat e zbatimit të dokumentin të Ahtisarit, se më tepër jam i përqendruar në çështjet që kanë të bëjnë me Bashkimin Evropian. Por, së pari, duhet të merret parasysh Pakoja e Ahtisarit, sepse ka të bëjë me ndërtimin e shtetit dhe pastaj vijnë parimet e BE-së. E them këtë se pa e ndërtuar shtetin nuk mund të respektohen as parimet e BE-së, por nëse do të jetë e mundshme të zbatohen të dyja në të njëjtën kohë, atëherë do të kishte përparim drejt integriteteve evropiane.

Kryetarja e komisionit – E falënderoi z. Dinelli për prezantimin e bërë para Komisionit si dhe për kontributin e tij.

4. Të ndryshme

4.1. Zylfije Hundozi – E njoftoi Komisionin për ftesën zyrtare që z. Neven Mimica, zv. kryetar i Parlamentit Kroat dhe kryetar i Komisionit të Integriteteve Evropiane ua kishte bërë të gjithë anëtarëve të Komisionit për një vizitë zyrtare në Parlamentin Kroat më 9 - 11 korrik 2008. Ftesa i referohet shkëmbimit të informatave lidhur me procesin e zgjerimit të BE-së.

I pyeti anëtarët e Komisionit se a pajtohen që të shkojë i tërë Komisioni me këtë datë, sepse konfirmimi duhet të bëhet me kohë.

Edita Tahiri - Vlerësoj se pasi Komisioni ka edhe një vizitë në Shqipëri, propozoj që gjysma e Komisionit të shkojë në Kroaci e gjysma tjetër në Shqipëri.

Zylfije Hundozi - Tha se edhe në Shqipëri, edhe në Kroaci është i ftuar i gjithë Komisioni, andaj nuk kemi nevojë të ndahemi, sepse për Kroaci shpenzimet do t'i mbulojë Friedrich Herbert Stiftung, kurse për Shqipëri NDI-ja dhe janë në kuadër të programit tonë.

Sabri Hamiti - Tha se sa i përket vizitës në Shqipëri kemi pasur raporte me Komisionin për Marrëdhënie me Jashtë dhe ka pasur nivel reciprok. Është reciprocitet - sa anëtarë kemi shkuar në Shqipëri aq edhe kanë ardhur. Andaj, nëse shkojmë 11 anëtarë, atëherë

duhet t'i presim 11, atëherë të mendojmë për këtë dhe mos të shkojmë si komision në përbërje të plot

Naser Rrugova - Konsideron se duhet të shkojë i tërë Komisioni. Komision si i ri ka nevojë për kontakte të tilla, sepse diplomacia parlamentare e ka rolin e fuqizimit edhe të kontakteve. Tani është një ngecje totale e diplomacisë. Të dy donatorët na kanë ftuar të gjithëve, andaj të shkojmë si grup dhe t'i njohim përvojat e tyre. Propozoj që në këto dy vizita të shkojmë si ekip, kurse në vizitat e tjera të bëhet një balancë e përfaqësimit partiak.

Nait Hasani - Mendon se duhet të shkojë i tërë Komisioni dhe se është absurde të thuhet të mos shkojë i tërë Komisioni, sepse në Kuvend ekziston buxheti për këtë komision dhe kemi mundësi edhe ne ta ftojmë krejt komisionin tjetër, sepse jemi shtet.

Zylfije Hundozi - Tha, pasi për vizitën në Shqipëri, që ishte vendosur në mbledhjen e kaluar, të shkojë Komisioni më 14-16 korrik, ende nuk i ishte bërë kërkesa Kryesisë së Kuvendit. Ajo kërkoi nga Sekretaria t'i bëhet kërkesa Kryesisë për vizitën në Shqipëri dhe në Kroaci, andaj nxori këtë

Përfundim

Kryesisë t'i bëhen 2 kërkesa: 1. kërkesa për lejimin e vizitës në përbërje të plotë në Parlamentin e Shqipërisë dhe 2. kërkesa për lejimin e vizitës në përbërje të plotë në Parlamentin e Kroacisë.

4.2 Zylfije Hundozi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se OSBE-ja e organizon dhe e financon një vizitë për një delegacion të Komisionit të Integritetit Evropian në përbërje prej 7 anëtarësh. Vizita pritet të organizohet në shtator, mirëpo tha se ata po i kërkojnë emrat e anëtarëve të Komisionit që duan të udhëtojnë, për t'u bërë përgatitjet me kohë. Lidhur me këtë hapi diskutimin.

Nait Hasani - Kërkoi të shkojë tërë Komisioni në Bruksel, pasi shpenzimet OSBE-ja i mbulon për 7 anëtarë. Kërkoi të bëhet kërkesë në Kryesi që për 4 anëtarët e tjerë shpenzimet t'i mbulojë Kuvendi i Kosovës.

Njomza Emini - Mendon se për fillim si komision i ri në këto vizita duhet të shkojë i tërë Komisioni. Nuk pajtohet me z. Hamiti që të mos shkojë nëpër vizita i tërë Komisioni dhe tha se nuk e dimë ngurrimin e Kryesisë për vizita.

Kryetarja konstatoi se Komisioni nuk ka kuorum, andaj e nxori këtë

Përfundim

Në mbledhjen e radhës të caktohen emrat e anëtarëve që do të udhëtojnë për në Bruksel.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20 min.

Procesverbalin e hartoi
Ahtere Loxha

Kryetarja e Komisionit
Zylfije Hundozi